

## MENDIM PARALEL

Unë, anëtarja e trupit gjykues nr. 1, Valbona Sanxhaktari, parashtoj mendimin tim paralel ndaj arsyetimit të vendimit nr.181, datë 18.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit znj. Elida Kaçkini, me detyrë prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Parashtrimi i arsyetimit të mendimit paralel lidhet me qëndrimin ndryshe në raport me vlerësimin e disa rrethanave dhe arsyetimit të përdorur nga shumica e trupit gjykues, dhe që nuk ndikon në vendimin për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Elida Kaçkini.

Ky qëndrim ka të bëjë me përfshirjen në vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të vlerësimit të një pasurie në emër të personit të lidhur, e cila në fakt gjatë hetimit rezultoi se ishte nje pasuri e vënë veçmas dhe nuk ndikonte vetë subjektin e rivlerësimit.

Në vlerësimin tim, vendimi përfundimtar për subjektin e rivlerësimit duhet të bazohet vetëm mbi prova që i përkasin çështjes së subjektit të rivlerësimit.

Konkretisht lidhur me pasurinë: apartament banimi, me sipërfaqe 78.33 m<sup>2</sup>, \*\*\*, Komuna Kashar, deklaruar nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, shprehem kundër arsyetimit të shumicës së trupit gjykues.

Komisioni ka hetuar mbi pasurinë e personit tjetër të lidhur, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit z. B.K., pasi kjo pasuri është deklaruar në formularin “Vetting” si pasuri e personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit. Po ashtu edhe për faktin se subjekti i rivlerësimit jeton aktualisht në këtë apartament së bashku me bashkëshortin e saj.

Nga hetimi administrativ, Komisioni konstatoi se ky apartament është porositur me anë të kontratës së porosisë nënshkruar midis personit të lidhur, z. B.K., dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në datën 5.1.2010, në vlerën 38,260 euro.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga “Intesa Sanpaolo Bank”, vërtetohet se personi i lidhur, z. B. K., ka kryer pagesën për shoqërinë sipërmarrëse “\*\*\*\*” sh.p.k., me anë të një transferte bankare në datën 5.1.2010, për të gjithë shumën.

Nga dokumentacioni i administruar nga zyra e gjendjes civile, u vërtetua se subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë ligjore me personin e lidhur, z. B. K., në datën 30.11.2012 dhe ka filluar bashkëjetesën me të.

ZVRPP-ja Tiranë konfirmon se z. B. K., në datën 14.12.2011 ka regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, pasurinë me sipërfaqe 78.33 m<sup>2</sup>, si pronar i vetëm i kësaj pasurie.

Në vijim të këtij hetimi, në vlerësimin tim, trupi gjykues duhet të vlerësonte faktet dhe provat e administruara, të cilat të çojnë në konkluzionin se kjo pasuri nuk i përket subjektit të rivlerësimit, e se është pasuri ekskluzive e personit të lidhur që nuk afekton vetë subjektin e rivlerësimit.

Nga vlerësimi i fakteve dhe dokumentave të administruara gjatë hetimit, rezultoi e provuar, çka është deklaruar edhe në vendimin e arsyeuar nr.181, datë 18.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, se kjo pasuri nuk i përket subjektit të rivlerësimit dhe nuk afekton atë.

Në vlerësimin tim, trupi gjykues pas administrimit të provave dhe infomacionit provues se kjo pasuri ishte ekskluzive e personit të lidhur, duhet të kishte vendosur mospërfshirjen e kësaj pasurie në arsyetimin e vendimit nr. 181, datë 18.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe aq më tepër nxjerrjen e konkluzioneve për rrethana që nuk ndikojnë subjektin e rivlerësimit, por drejtpërdrejt një subjekt tjetër për të cilin duhet të ketë një proces rivlerësimi të ndarë.

Mendoj që vlerësimi i shumicës se “Rethana e analizuar me sipër në vendim, nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit” vjen si rezultat i një analize jo të drejtë që është në kapërcim të dispozitave ligjore që parashikojnë procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqatrëve dhe prokurorëve.

Lidhur me faktin se shtetasit B. K., (vjehri) dhe shtetasja E. D., janë konsideruar persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit – për shkak të huadhënies së shumave përkatësisht nga 12.000 euro personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit, në vlerësimin tim trupi gjykues ka dalë jashtë përcaktimit të pikës 15 të nenit 3 të ligjit, si dhe jashtë objektit të vlerësimit të Komisionit, lidhur me procesin e rivlerësimit të znj. Elida Kaçkini.

Gjatë hetimit, Komisioni ka konstatuar se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit është gjithashtu subjekt rivlerësimi sipas ligjit nr. 84/2016, dhe ky vendim në asnjë rast nuk duhet të paragjykojë të drejtën për një hetim të pavarur të paanshëm dhe një rivlerësim të tij në përputhje me ligjin. Vendimi i dhënë në këtë rast nuk duhet të ndikojë drejtësinë dhe objektivitetin e procesit të rivlerësimit të z. B.K. Trupi gjykues ka dalë jashtë kompetencave të përcaktuara nga ligji nr. 84/2016, pasi ai duhej të shprehej vetëm bazuar në provat që i përkasin çështjes së subjektit të rivlerësimit dhe në zbatim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit. (vendimi nr. 20 (JR) datë 31.07.2019 i KPA).

Praktika të ngjashme Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka ndjekur edhe për raste të tjera si psh në vendimi nr.27, datë 25.6.2018.

**Anëtari**

**Valbona Sanxhaktari**